



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 21.05.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 20.05.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik, " **ARCHING GROUP** " SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ndërtimi dhe Rikonstruimi i ndriqimit publik në rrugën, Sadik Shala, Ganimete Tërbeshi, dhe Afrim Zhitia në Lipjan me Nr. të Prok: 613-25-1854-5-2-1

V E N D I M

Hedhet poshtë si e jashtë afatshme, kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " **ARCHING GROUP** " SH.P.K të dt. 20.05.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi dhe Rikonstruimi i ndriqimit publik në rrugën, Sadik Shala, Ganimete Tërbeshi, dhe Afrim Zhitia në Lipjan me Nr. të Prok: 613-25-1854-5-2-1

Vërtetohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë për Operatorin ANESI SH.P.K
Mbetet në fuqi Vendimi i AK për shpërblim me kontratë i publikuar me datë: 14.05.2025

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik " **ARCHING GROUP** " SH.P.K me datë 20.05.2025 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi dhe Rikonstruimi i ndriqimit publik në rrugën, Sadik Shala, Ganimete Tërbeshi, dhe Afrim Zhitia në Lipjan me Nr. të Prok: 613-25-1854-5-2-1
ku këtë aktivitet AK ka shpallur fitues Operatorin Ekonomik ANESI SH.P.K **për shpërblim me kontratë** të datës 14.05.2025 dhe ka publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

Operatori Ekonomik " **ARCHING GROUP** " SH.P., me datë. 20.05.2025 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi dhe Rikonstruimi i ndriqimit publik në rrugën, Sadik Shala, Ganimete Tërbeshi, dhe Afrim Zhitia në Lipjan me Nr. të Prok: 613-25-1854-5-2-1

Në bazë të "**Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave**", neni 4 pika b ne të cilin thuhet: Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit

Dhe në bazë të **Ligjit nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092**, neni 5 për kalkulimin e afateve kohore pika 1 dhe 2 në të cilët thuhet:

Pika 1. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.

Pika 2. Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj

Në bazë të këtyre rregullave dhe Ligjit të prokurimit publik ju keni paraqitur kërkesë për rishqyrtim jashtë afatit ligjor, përkatësisht këtë kërkesë për rishqyrtim e keni paraqitur në ditën e 6 dhe si e tillë kërkesa për rishqyrtim hudhet poshtë.


AK, konsideron se tenderi juaj është vlersuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Bekim Shabani



Drejtor i Prokurimit